



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 02.

Prishtinë, më 30.03.2011 ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-323

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Rašić, Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živković, Jelena Bontić, Petar Miletić, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi .

Emrat e pjesëmarrësve të tjerë: përfaqësues nga OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesi nga Ambasada Zvicrane Sakibe dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Rašić, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar 21.03.2011**
- 3. Shqyrtimi i Draft- Planit dhe programit të punës për vitin 2011**
- 4. Shqyrtimi i shkresës të Partisë Demokratike Boshnjake br. 04/96 Doc 73 të datës 21.03.2011, lidhur me korrigjimin e formularit për regjistrim.**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe papi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me pëlqim të pikës shqyrtimi i Raportit me rekomandime lidhur me Projektligjin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar 21.03.2011

Kryesuesi - ka konstatuar se procesverbali i mbledhjes së datës 21.03.2011 është miratuar me vërejtjen e Rasim Demirit me tekstin si vijon: lidhur me përmbajtjen e shkresës është bërë një lëshim, ku në listë për regjistrim figuron fjala ‘ boshnjake’ ndërsa duhet të zëvendësohet me fjalën bosanski.

3. Shqyrtimi i Draft- Planit dhe programit të punës për vitin 2011

Kryesuesi – theksoi se komisioni është i obliguar të hartojë Draft Planin e punës, të modifikojë ndryshimet eventuale të propozuara nga anëtarët e komisionit dhe përfundimisht të miratohet në parim. Lidhur me këtë pikë hapi debat që atëtarët e komisionit të njoftohen me përmbajtjen e Planit të punës. Lidhur me këtë pikë fjalën ua dha anëtarëve të komisionit.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit - para komisionit i paraqiti të gjitha propozimet, sygjerimet lidhur me programin e punës dhe iniciativat e propozura nga përfaqësueset e OSB gjatë hartimit të Planit të punës. Diskutoi para Komisionit se i njëjti paraqet programin preliminar i cili mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas kërkesave dhe nevojave të Komisionit.

Petar Miletic- kërkoi sqarim lidhur me paraqitjen e propozimeve të cilat i ofron personeli i komisionit dhe shtoi se ka aktivitete të cilat nuk janë paraqitura ne programin e punës andaj nuk mund të miratohet në këtë formë. Propozoi të tejkalohet kjo pikë e rendit të ditës, më pas i njëjti të plotësohet me ndryshimet që komisioni do ti inkorporojë dhe më pas të miratohet në parim.

Kryesuesi – theksoi se komisioni duhet domosdoshmërisht ta ketë të hartuar programin e punës sepse jemi të kufizuar në kohë, Më pas dha propozim që ditën e nesërme komisioni të mbajë një takim ku do të inkorporohen ndryshimet eventuale dhe i njëjti të miratohet në parim.

Ai theksoi se në bazë të agjendës të Strategjisë legislative dhe planit të veprimit, komisioni ka mundësi të plotësojë dhe ndryshojë planin e punës për vitin 2011.

Njëherit falenderoi të gjitha organizatat për përkrahje dhe ndihmë që ofrojnë komisionit, posaqërisht falenderoi OSB-në e cila tani mbështetë komisionin tonë që të kemi plan sa më të mirë të punës.

Petar Miletic- duke u ndërlidhur, propozoi që Draft plani të miratohet me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara nga njësia për mbështetjen e Komisionit, ndërsa propozoi që komisioni në një periudhë të caktuar kohore të plotësojë Planin periodike për vitin 2011.

Myzejene Salmanaj- Sa i përket planit të punës propozoi që i njëjti të plotësohet nga stafi mbështetës në bashkëpunim me përfaqësuesit e OSB-së. ku ditën e nesërme komisioni ta rishikojë dhe sipas procedurave të dërgohet në kryesi për miratim.

Myfera Sinik- pajtohet që Draft plani i plotësuar të miratohet në parim, ndërsa propozoi që në tabelë të programit të punës të plotësohen edhe disa qytete: Gjilan, Mamusha dhe Ferizaj.

Lumnije Morina – përkrah propozimet e parafolësve që Draft plani i punës të miratohet në parim kurse sugjeroi që në ndonjë mbledhje të radhës, komisioni të inkorporojë edhe sugjerimet tona.

Agim Kuleta – përkrah propozimet e dala në këtë mbledhje dhe njëherit pajtohet që komisioni të miratoi Draft planit e punës.

Elita Vokshi – falënderoi stafin mbështetës për përpilimin e draft plani të parë të punës dhe shtoi se komisioni duhet të angazhohet dhe të ofrojë propozimet e veta që të hartohet Plan i përfundimtar.

Sa i përket adaptimit të plani të punës, ajo propozoi që do të mbahet një punëtori dy ditore në territorin e Kosovës ku bashkarish me Komisionit Evropian do të plotësohet dhe kompletohet plani programi për vitin 2011

Sa i përket udhëtimeve zyrtare, lidhur me planin e veprimit të Komisionit Evropian është planifikuar vizita vetëm për kryetarin e komisionit në Bruksel, ndërsa vizitat tjera do të koordinohen bashkarish me kontakte të rregullta.

Kryesuesi- pas prezantimit të vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Draft –Plani i punës për vitin 2011 në parim me propozime për plotësim dhe ndryshim, ku më pas komisioni në javën e parë të muajit prill do të bëjë nismën e hartimit të plan programit të ri të punës për vitin 2011.

4. Shqyrtimi i shkresës të Partisë Demokratike Boshnjake br. 04/96 Doc 73 të datës 21.03.2011, lidhur me korrigjimin e formularit për regjistrim.

Rasim Demiri- sugjeroi komisionit të merr iniciativë që të bëhet korrigjimi i formularit të fletëregjistrimit në pyetjen e 11, ku në rubrikën 3 emërtimi „Bošnjački” të zëvendësohet me emërtimin „Bosanski.

Pas shqyrtimit të shkresës, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet shkresa e Partisë Demokratike Boshnjake nr. 04/96 Doc 73 të datës 21.03.2011, lidhur me korrigjimin e formularit për regjistrim ku të njëjtën adreson Komisionit Qendror të Regjistrimit, që të shqyrtoi shkresën për korrigjimin e fletëregjistrimit. Në lidhje me këtë urdhëron dhe sugjeron që të bëhet korrigjimi i formularit të fletëregjistrimit në pyetjen e 11 „ Cila është gjuha juaj amtare’?”, në rubrikën 3 emërtimi „Bošnjački” të zëvendësohet me emërtimin „Bosanski”, në pajtim me nenin 5.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 13.(b) të Ligjit nr. 2003/16, për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë.

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2011, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Mufeta Sinik deklaroi se në komisionin për Buxhet dhe Financa gjatë shqyrtimi të amendamenteve të Projektligjit për Buxhetin e Kosovës, nuk ka pas vërejtje andaj mendon se i njëjti duhet të miratohet pa vërejtje.

Pasi që nuk kishte vërejtje konkrete, Kryesuesi konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni ka shqyrtuar Raportin me amendamente të komisionit funksional dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Saša Rašić